



Metoda Kërkimi

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli



Kapitulli 2

Shkrimi i Propozimit për Temën e Kërkimit



Objektivat

- Të ktheni idetë e kërkimit në një projekt kërkimi
- Të shkruani një propozim për temën e kërkimit



Përmbajtja

1. **Hyrje**
2. **Qëllimi i propozimit për temën e kërkimit**
3. **Përmbajtja e propozimit**
4. **Kriteret e vlerësimit të propozimit për temën e kërkimit**
5. **Përmbledhje**



1. Hyrje

- **Shkrimi i propozimit për temën e kërkimit shkencor është një hap i rëndësishëm për kërkuesin**
 - Nëse ju jeni duke aplikuar për fonde të një projekti kërkimor
 - Edhe nëse jeni duke e prezantuar atë përpara një komisioni akademikësh kërkimi
- **Kjo do të thotë që duhet ti kushtoni kohën dhe rëndësinë e duhur**
- **Edhe nëse nuk kërkohet zyrtarisht një propozim për temën tuaj, ky është një proces që këshillohet të bëhet me kujdes**



2. Qëllimi i propozimit për temën

○ Të organizoni idetë

- Idetë do të qartësohen më shumë duke i shkruar në letër
- Jo vetëm do të qartësoni idetë tuaja por edhe do ti organizoni ato në një format më koherent dhe të qartë për ata që do ta dëgjojnë

○ Të bindni audiencën

- Sado koherente t'ju duken idetë tuaja, kjo nuk vlen nëse duket që ajo që po propozoni është e pamundur të realizohet
- Duhet të mbroni idetë tuaja dhe të jepni argumenta që tema juaj mund të realizohet në kohën dhe me burimet e disponueshme

○ Të bëni kontratën me klientin

- Nëse kërkimi që keni ndërmarrë është për një klient biznesi, propozimi është njëfarë kontrate për të bindur klientin për atë që po bëni dhe për shpërblimin që do të merrni



3. Përmbajtja e propozimit

- **Titulli**
- **Kuadri teorik (background)**
- **Pyetjet e kërkimit dhe objektivat**
- **Metoda**
- **Skeduli kohor**
- **Burimet**
- **Referencat**

Përmbajtja

○ Titulli

- Mund të jetë një titull provizor . Në këtë fazë duhet të pasqyrojë qartësisht përmbajtjen e propozimit

○ Kuadri teorik (background)

- Duhet ti tregojë lexuesit pse është i vlefshëm ky kërkim.
- Mund të shprehet në formën e një problemi që nevojitet të zgjidhet, ose diçka që ju ngacmon
- Këtu duhet të demonstoni njohuritë tuaja në lidhje me literaturën relevante
- Qartëson pozicionin që zë propozimi juaj në debatet në literaturë mbi këtë çështje
- Tregon lidhjet me punimet e mëparshme
- Do të jetë piknisja e punës tuaj
- Mos e ngatëroni me Rishikimin e Literaturës, duhet të ofrojë një pamje të burimeve kryesoret të literaturës ku do të mbështeteni

Përmbajtja

○ Pyetjet e kërkimit dhe objektivat

- Background duhet të drejtojë lexuesin gradualisht tek pyetjet e kërkimit dhe objektivat, të cilat duhet ti tregojnë lexuesit çfarë kërkoni të arrini me anë të kërkimi

○ Metoda

- Detajon mënyrën si do të arrini objektivat e kërkimit
- Justifikon përzgjedhjen e metodës për të arritur këto objektiva
- **Ndahet në dy pjesë:** dizenjimi i kërkimit dhe mbledhja e të dhënave
- **Dizenjimi i kërkimit**
 - Shpjegon se ku do ta ndërmerrni kërkimin, çfarë popullate do të zgjidhni, dhe pse do ta zgjidhni
 - Shpjegon mënyrën e përgjithëshme si do ta ndërmerrni kërkimin dhe pse, me anë të pyetsorëve, intervistave, etj
- **Mbledhja e të dhënave**
 - Shpjegon në mënyrë specifike si do të mblidhen të dhënat, si do të zgjidhni popullatën, kampionin, si do të analizoni të dhënat
 - Trajton dhe çështjet e etikës



Përmbajtja

○ Skeduli kohor

- E ndan planin tuaj të kërkimit në faza, për të qartësuar më mirë lexuesin se çfarë është e mundur të bëhet në secilën fazë
- Mund të përdorni grafikun Gantt i cili detajon detyrat dhe datat se kur do të realizohet secila

○ Burimet

- Lejon lexuesin të vlerësojë burimet që keni në dispozicion të cilat mund të kategorizohen në financiare, aksesit tek të dhënat, pajisjet, etj.

○ Referencat

- Nuk duhet të listoni referencat që mendoni se do ti përdorni gjatë gjithë punimit tuaj
- Duhet të përmendni disa burime kryesore të literaturës të cilave i jeni referuar në seksionin e *background*

4. Kriteret e vlerësimit të propozimit

- **Shkalla në të cilën komponentët e propozimit mbështesin njëri-tjetrin**
 - Arsyetimi për të drejtuar kërkimin duhet të përfshijë:
 - Studimin e publikimeve të mëparëshme, si dhe teoritë relevante
 - Ky studim duhet ti japë shtysë pyetjeve dhe objektivave të kërkimit
 - Metodologjia e propozuar duhet të rrjedh direkt nga këto pyetje dhe objektiva
 - Koha e planifikuar duhet të reflektohet direkt nga metodologjia dhe burimet që ju nevojiten
- **Realizueshmëria e propozimit**
 - A mund të realizohet kërkimi brenda skedulit kohor të planifikuar dhe burimeve në dispozicion?
- **Mungesa e një ideje të paramenduar**
 - Kërkimi duhet të jetë një udhëtim drejt të panjohurës dhe jo një kërkim që ju ja dini përgjigjet!!!



Vlerësuesit e propozimit

- **Sistemet ekspertë të tillë si Peer Review Emulator™ të cilët janë software të cilët mund të jenë pjesë e grupit të programeve Methodologist's Toolchest™**
 - Programi i bën një sërë pyetjesh kërkuesit në lidhje me propozimin dhe më pas i analizon ato duke gjykuar nëse kërkimi i arrin standardet apo jo.



5. Përmbledhje

- **Përmbajtja e propozimit të kërkimit duhet ti tregojë lexuesit**
 - Çfarë dëshironi të bëni?
 - Pse doni ta bëni?
 - Çfarë jeni duke u përpjekur të arrini?
 - Si po e planifikoni ta arrini?